



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:076470
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05739930

Ac.nr.7852/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B. S., të cilën me autorizim e përfaqëson Sh. Xh., avokat në Gjilan, ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria për Arsim, përfaqësuar nga B. D., avokat në Gjilan, objekti i kontestit kompensim i të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.228/2020, të datës 30.06.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.228/2020, të datës 30.06.2021 dhe çështja lëndore gjykohet si në vijim: **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesëpatria e paditëses B. S. nga Gjilani dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, që paditëses t’ia kompensojë të ardhurat personale për vendin e punës Edukatore në Entet Parashkollore të qytetit të Gjilanit, për periudhën kohore prej datës 01.09.2008 e deri me datën 01.04. 2014 në shumë neto prej 19,495.08€ dhe interesin për këtë periudhë kohore në shumë prej 2,748.90€, kontributet pensionale në emër të paditëses në shumë prej 1,097€, kontributet pensionale në emër të punëdhënësit në shumë prej 1,097€, tatimin në paga në shumë prej 802.16€, gjithsej shumën prej 25.240.14€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, prej datës 02.04.2014 e deri në pagesën definitive, gjithë këto në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të aktgjykimit, nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Gjykata Themelore në Gjiilan me aktgjykimin e atakuar, C.nr.228/2020, të datës 30.06.2022, ka vendosur si vijon: MIRATOHET në tërësi kërkesëpapia e paditëses B. S. nga Gjiilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjiilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjiilan, që paditëses t'ia kompensojë të ardhurat personale për vendin e punës Edukatore në Entet Parashkollore të qytetit të Gjiilanit, për periudhën kohore prej datës 01.09.2008 e deri me datën 01.04. 2014 në shumë neto prej 19,495.08€ dhe interesin për këtë periudhë kohore në shumë prej 2,748.90€, kontributet pensionale në emër të paditëses në shumë prej 1,097€, kontributet pensionale në emër të punëdhënësit në shumë prej 1,097€, tatimin në paga në shumë prej 802.16€, gjithsej shumën prej 25.240.14€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, prej datës 02.04.2014 e deri në pagesën definitive, gjithë këto në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të aktgjykimit, nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm. DETYROHET e paditura Komuna e Gjiilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjiilan, që paditëses B. S. t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestuese në shumë prej 2,626.56 euro/cent, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura përmes përfaqësuesit të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe çështjen t'ia kthejë të njëjtës gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje apo ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëses. Ndër shkeljet që në ankesë pretendohet të përmbajë aktgjykimi janë se gjykata nuk kishte kompetencë lëndore për të vendosur për këtë çështje, më pas se vendimi është kontradiktor. Ka shtuar se paditësja nuk kishte të themeluar marrëdhënie pune me kontratë pune me të paditurën dhe nuk është vërtetuar se pse e paditura kishte obligim financiar me të paditurën.

Paditësja përmes përfaqësuesit të saj ka ushtruar përgjigje në ankesë, duke propozuar të refuzohet ankesa ndërsa aktgjykimi të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja M. B. nga Gjiilani, përmes të autorizuarit të saj, me datë 28.10.2014, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, të cilën e ka precizuar përmes parashtrësës së datës 21.05.2021. Ajo pretendonte se kishte aplikuar në vitin 2008 në vendin e punës edukatore në Shkollën Fillor "Th. M" në Gjiilan, mirëpo nuk ishte përzgjedhur, më pas ajo kishte ushtruar ankesë pranë komisionit të ankesave i cili kishte rekomanduar të sistemohej në vendin punës si edukatore në një nga entet parashkollore të qytetit. Përkundër kësaj, e paditura nuk e kishte sistemuar paditësen, ajo i drejtohet me ankesë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, i cili me datë 06.07.2009 kishte obliguar të paditurën të zbatonte rekomandimin e komisionit të ankesave. Përfundimisht e paditura përmes vendimit të datës 01.04.2014 kishte sistemuar të njëjtën në vendin e punës si edukatore.

Gjykata e shkallës së parë ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datë 21.05.2021 dhe pas, administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.228/2020, të datës 30.06.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka administruar provat Rekomandimi i Komisionit të Ankesave i Kuvendit Komunal në Gjiilan me numër të protokollit 03-9340/2 i datës 15.10.2008, Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës me numër 02/313/2008 i datës 06.07.2009, Vendimi për zbatimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan lëshuar nga DKA në Gjiilan i datës 01.04.2014, Kërkesa për kompensimin e paraqitur nga i autorizuarit të paditëses i datës 10.09.2014 adresuar DKA-së, Përgjigja në kërkesë e DKA-së, e datës 15.09.2014, ankesa e të autorizuarit të paditëses adresuar Komisionit për Ankesa të Komunës së Gjiilanit e datës 22.09.2014, Referenca e DKA-së e datës 20.06.2016, ekspertiza financiare e datës 18.12.2020, pasqyra e llogarisë së Trustit të datës 01.08.2000 deri me datën 15.04.2021. Në arsyetim janë paraqitur arsyet se paditëses në mënyrë të kundërligjshme nuk i është mundësuar fillimi i punës nga data 01.09.2008 e deri me datën 01.04.2014, pasi që të gjitha kërkesat e saja pranë organeve kompetente kanë qenë valide dhe të njëjtat kërkesa i janë aprovuar në favor të saj, për këto arsye gjykata vendosi që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet dhe të obligohet e paditura Komuna e Gjiilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjiilan, që paditëses t'ia kompensojë të ardhurat personale për vendin e punës edukatore në Entet Parashkollore të qytetit të Gjiilanit për periudhën kohore prej datës 01.09.2008 e deri me datën 01.04.2014 në shumë neto prej 19,495.08€, interesin për këtë periudhë kohore në shumë prej 2,748.90€, kontributet pensionale në emër të paditëses në shumë prej 1,097€, kontributet pensionale në emër të punëdhënësit në shumë prej 1,097€, tatimin në paga në shumë prej 802.16€, e gjithsej shumën prej 25.240.14€.

Më tej ka arsyetuar se kërkesëpadia është e bazuar konform nenin 78 të Ligjit të Punës, për sa i përket të ardhurave personale. Për shpenzimet të procedurës ka vendosur sipas nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, për këtë gjë u desh që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të gjykohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së sepse gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare, është paraqitur qëndrimi lidhur me mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë. Nuk mund të pranohet pretendimi për këtë shkelje sepse pjesa e ndryshuar e aktgjyimit ka të bëjë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale e jo me arsyetimin e gabuar. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë e ka paracaktuar edhe arsyetimin e aktgjyimit për kompensimin e pagave, në atë mënyrë që përfundimi meritor është arsyetuar në përputhje me dispozitat e LPK-së, pavarësisht se një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë, gjykata ankimore e ka ndryshuar.

Kolegji i kësaj gjykate gjithashtu vlerësoi si të pa bazuar pretendimin për sa i përket shkeljes së pretenduar nga neni 391 par. 1 pika (f), përsa i përket kompetencës lëndore, ngase bazuar në natyrën e rastit, pozitën që kishte aplikuar paditësja dhe të ardhurat që kërkon, gjykata e shkallës së parë kishte kompetencë për vendosjen e këtij rasti.

Po ashtu sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me provat e administruara në asnjë fazë të procedurës nuk është kontestuar se paditësja ishte pjesë e procedurave të rekrutimit për vendin e punës si edukatore në shkollën fillore “Th. M.” në Gjilan. Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se paditësja i ishte drejtuar me ankesë komisionit të ankesave, kurse më pas i njëjti komision kishte rekomanduar që paditësja të sistemohej edukatore entet parashkollore të Gjilanit. Po ashtu është vërtetuar se edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës kishte obliguar të paditurën të zbatonte rekomandimin e komisionit të ankesave, kurse përfundimisht me datë 01.04.2014, e paditura nxjerr vendim që paditësja të sistemohet si edukatore. Paditësja kërkonte pagat për periudhën nga koha kur ishte njoftuar për mos zgjedhje, deri me datën kur ishte sistemuar në vendin e punës ku kishte aplikuar më parë. Nga analizimi i pretendimit ankimor që i përket mos vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje nga neni 183 i LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës vlerëson se në këtë rast kontestues, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, ngase një gjendje e tillë faktike nuk mund të krijojë detyrim të tillë financiar për paga për të paditurën. Aplikimi i nenit 80 të Ligjit të Punës, siç është bërë në këtë rast, nuk mund të pranohet, ngase sipas të tij: *Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore..., kurse përkundër faktit se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se paditëses nuk i është ndërpre marrëdhënia e punës, por e njëjta nuk ishte zgjedhur, ka aplikuar të drejtë materiale që nuk korrespondon me gjendjen faktike të vërtetuar, kjo ngase norma e tillë krijon detyrim për kompensimin e pagave, pasi një të punësuarit i shkëputet kontrata e punës në mënyrë jo të ligjshme.*

Kjo gjykatë vlerëson të theksojë se duhet të bëhet dallim në mes të rastit kur kërkohet mbrojtje nga shkelja e të drejtave nga marrëdhënia e punës, kur një person nuk kompensohet me të ardhurat personale, apo largohet në mënyrë të paligjshme nga marrëdhënia e punës, me rastet kur ka qenë subjekt i procedurave të rekrutimit mirëpo nuk është zgjedhur. Në rastin kontestues për periudhën që kërkohet të behet kompensimi pagave, paditësja nuk ka qenë e zgjedhur si e punësuar pranë të paditurës, gjegjësisht ajo nuk ka pasur të themeluar marrëdhënie pune, prandaj e paditura nuk mund të detyrohet në kompensimin e pagave. Komisioni i ankesave i të paditurës, me rastin e aprovimit të ankesës së saj, vetëm kishte rekomanduar sistemimin në vendim e punës, kurse pas këtij vendimi, nuk është themeluar marrëdhënia e punës pra nuk ka pasur të nënshkruar kontratë apo akt të themelimit të marrëdhënies së punës. Neni 10 par. 1 i Ligjit të Punës parashikon *“Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji.”* Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se marrëdhënia e punës është një marrëdhënie që rregullohet juridikisht përmes kontratës së punës. Kontrata e punës përfaqëson një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhënien e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Përmes saj punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose

shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të punëdhënësit, në kundërvlerë të pagës mujore.

Ligji i Punës, në nenin 55 par. 1 dhe 2 rregullon “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit. E paditura me akt të brendshëm të nxjerrë, ka marrë vendim me datë 01.04.2014 që paditësen ta sistematizojë si edukatore, kurse pasojat juridike të atij vendimi kanë lindur që nga ajo kohë si detyrim i të paditurës për kompensimin e pagave, kurse në kuptim të përmbushjes së pagave, periudha para nxjerrjes së këtij vendimi, nuk mund të konsiderohet si detyrim në kuptim të pagave për paditurën.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi pasi që nga arsyet e theksuara si më sipër vlerëson se kërkesëpadia e paditëses për shpërbllim jubilar nuk ka bazë ligjore e nga e cila edhe u determinua vendosja për shpenzimet e procedurës konform nenit 452, paragrafi 1 të LPK-së, pasi që paditëses si palë e cila e ka humbur kontestin nuk i takojnë shpenzimet e kërkuara, ndërsa e paditura shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Prandaj nga arsyet e theksuara gjykata ankimore vlerëson se kërkesëpadia e paditëses për kompensim të pagave nuk ka bazë ligjore, e me referim në dispozitën e nenit 195, paragrafi 1 pika e), lidhur me nenin 201 paragrafi 1, pika d) të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.7852/2021, më datë 23.05.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli